

Të dashur miq dhe të ftuar,

Jam shume i nderuar qe pershendes une kete Konference te dyte te Tekstilit te organizuar nga Departamenti i Tekstilit në Fakultetin Tonë

Ky Departament, në Fakultetin e Inxhnierisë Mekanike sot ka përgatitur një kurs të ri studimi në kuadër të Kartës së Bolonjës atë të Inxhnierisë tekstile dhe të modës duke u mbështetur në:

- traditën e degës së inxhnierisë tekstile në Universitetin Politeknik
- modelet italiane të shkollave të ngjashme
- dhe njohjes së nevojave të tregut të punës në Shqipëri

Ristrukturimi i programeve dhe planeve mësimore konform modeleve të universiteteve perëndimore në Departamentin e Tekstilit bënë që në këtë Departament të kemi sot një degë jo vetëm me emërtim të ri por dhe të aftë për t'u konvertuar me shkollat perëndimore gjë për të cilën dega e tekstilit ka vuajtur në këto vite.

Departamenti i Tekstilit wshtw përkrahur vazhdimisht nga Dekanati i FIM në drejtimet e punës së tij mësimore shkencore dhe aktivitetet e veta të shërbimit ndaj të tretëve.

Ndihma e Fakultetit për këtë Departament

Kualifikimet e disa anëtarëve të stafit pedagogjik të Departamentit të Tekstileve në universtitet politeknike të Torinos (Itali), Aachen (Gjermani), Muolhouse (France), Milano (Itali), Ghent (Belgjikë) në kuadrin e projekteve Tempus ishin një ndihmë e madhe në procesin e ristrukturimit të curriculës së inxhnierit tekstil dhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të organizimit të degës së inxhnierisë tekstile në Fakultetin e Inxhnierisë Mekanike.

Sot, studentët që ndjekin studimet pranë Departamentit të Tekstilit, marrin njohuritë e para tekstile në semestrin e pestë dhe i vazhdojnë ato deri në semestrin e IX duke vazhduar më pas me projekt diplomën dhe laurimin përfundimtar si “Inxhnierë Tekstili”. Njohuritë e mara nga studentët e degës së inxhnierisë tekstile synojnë harmonizimin e teorisë me praktikën e cila kryhet pranë ndërmarjeve prodhuese dhe laboratorët e këtij Departamenti.

Dhënia e informacionit është konceptuar e tillë që studenti të marrë dije të thella në fushat e teknologjisë së filaturimit, tezgjahimit, trikotimit, teknologjisë së prodhimit të veshjeve, të modelimit dhe konstruktimit inxhnierik të veshjeve, të përmbartimit të tekstileve etj.

Duhet të theksoj që kurrikula tekstile është kontribut edhe i Departamentëve të tjerë si ai i Mekanikës, Manaxhimit të Prodhimit, Energjitikës në Fakultetin e Inxhnierisë Mekanike, të Matematikës, Fizikës, Kimisë etj në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Një ndër Laboratorët e këtij Departamenti, ai Fiziko – Mekanik dhe Kimik i Tekstilit është laborator i parë dhe i vetmi i akredituar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Standartizimit, sipas standarteve ndërkombëtare i Universitetit Politeknik të Tiranës që nga viti 1996 për kryerjen e analizave të plota laboratorike dhe kontrollin cilësor të produkteve, gjysëm produkteve dhe lëndëve të para tekstile.

Jo vetëm laborator i akredituar i tekstilit por edhe përfshirja e stafit pedagogjik të këtij Departamenti në projekte kombëtare dhe lokale përbëjnë një lidhje të fortë që Departamenti i Tekstilit po krijon me prodhimin industrial në Shqipëri.

Duke vlerësuar përpjekjet e stafit aktual të Departamentit të Tekstilit ing. Genti Guxho, ing. Enno Bozdo, ing. Artan Samara, ing. Ermira Shehi, ing. Blerina Kolgjini dhe Ilda Kazani në drejtim të kualifikimit të tyre shkencor, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në degën e inxhiniersë tekstile, të pedagogëve të jashtëm si Lefter Samara, Arben Fagu, Isa Feçi, Vojsava Karagjozi, Fatmir Demneri dhe Arlinda Shalësi i uroj ata dhe gjithë pjesmarrësit e kësaj Konference për 20 – vjetorin e Departamentit të Tekstilit dhe për punime të mbara.

Faleminderit.